Albanian-American Development Foundation

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

CleanScore

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Fakulteti i Mjekësisë

Departamenti i Mjekësisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE 2

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Shëndet publik

"Perceptimi i qytetarëve mbi vaksinimin e detyruar në Shqipëri "

Punoi: Emanuel Merkuri

Mjekësi e Përgjithshme, Viti III

Tiranë 2021

1.Hyrje

Bota ka ndryshuar me një shpejtësi marramendëse që nga sindroma e rëndë respiratore akute Coronavirus 2 (SARS-CoV-2). Virusi që shkaktoi sëmundjen e koronavirusit 2019 (COVID-19), nxiti një ndryshim drastik dhe të papritur në mënyrën sesi organizohemi ne si qenie njerëzore sociale. Ndërsa COVID-19 vazhdon të përhapet në të gjithë globin dhe politika të tilla si vaksinimi i detyrueshëm janë ndërrmarë nga shtete të ndryshme, është e rëndësishme të kuptojmë ndikimin që një politikë e tillë do të ketë për qytetarët shqiptarë dhe perceptimin e tyre mbi efektet e vaksinimit të detyrueshëm.

Qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi i qendrimeve të qytetarëve në lidhje me politikën e vaksinimit të detyrueshëm. Studimi përfshin 227 qytetarë të grupmoshës 18-61+, të cilët do ti nënshtrohen një pyetësori online. Kërkimi empirik do të shtrihet në disa qytete të Shqipërisë, duke përfshirë Tiranën, Durrësin, Fierin, Vlorën dhe qytete të tjera, të përzgjedhura për shkak se këto qytete kanë një numër të lartë të popullsisë aktive në internet, në të cilin do të mblidhen të dhënat.

Qasja metodologjike që do të përdoret është ajo sasiore, duke mbledhur dhe gjeneruar të dhëna nëpërmjet studimit të rasteve të shumta. Deri më sot në vendin tonë nuk është ndërmarrë asnjë hulumtim që demonstron qendrimet ndaj vaksinimit të detyrueshëm në mesin e qytetarëve dhe ajo që dihet është e kufizuar nga raportet apo reportazhet e transmetuara në media. Studimi adreson këtë boshllëk, duke ekzaminuar gadishmërinë për tu vaksinuar dhe pritshmëritë përsa i përket të ardhmes në këndvështrimin e të anketuarve.

1.1 Qëllimi i punimit:

Të analizoj qëndrimet e qytetarëve shqiptarë mbi vaksinimin e detyruar në Shqipëri dhe gatishmërinë e tyre për tu vaksinuar.

1.2 Objektivat e studimit:

1. Të përshkruhet gadishmëria e qytetarëve për tiu nënshtruar vaksinimit të detyrueshëm.

2. Të identifikohen faktorët që ndikojnë në vendimin për tu vaksinuar ose jo.

3. Të përshkruhen qendrimet e mbajtura ndaj politikës së ndjekur të vaksinimit të detyrueshëm.

1.3 Pyetjet kërkimore:

1. Sa të gatshëm janë qytetarët t"i nënshtrohen vaksinimit të detyruar në Shqipëri?

2. Si perceptohen efektet dhe pasojat e politikës së vaksinimit të detyrueshëm?

2.Zhvillimi

2.1 Rishikimi i literaturës

Strategjitë e vaksinimit kanë dy objektiva kryesore: uljen dhe vonimin e madhësisë së pikut ("rrafshimi i kurbës") si dhe zvogëlimin e popullsisë së infektuar për të kufizuar sëmundshmërinë (Feng, Z., Towers, S. & Yang, Y 2011). Me shfaqjen e vaksinave kundër COVID-19, vlen të pyesim nëse administrimi i tyre duhet të mbahet si vullnetar, gjë që nga ana tjetër ngre pyetjen se deri në çfarë mase liria individuale mund dhe duhet të mbizotërojë mbi të mirën e përbashkët shoqërore (Kheng, K. S., & Hasbullah, N. E. 2020).

Lëvizjet për ta bërë vaksinën të detyrueshme kanë ndezur një raund të ri të debateve polarizuese. Ligjet që e bëjnë vaksinimin të detyrueshëm ngrenë çështje unike, etike dhe

politike. Nivelet e larta të imunitetit masiv mbrojnë të gjithë anëtarët e komunitetit, përfshirë ata që nuk mund të marrin vaksina për shkak të kundërindikacioneve mjekësore. Kjo mbrojtje përbën një justifikim për detyrimin. Të dhënat tregojnë se shkollat, me shkallë përjashtimi të ulët nga 2 deri në 4% janë në rrezik të shtuar për shpërthime të sëmundjeve dhe se fëmijët e pavaksinuar kanë një rrezik shumë më të madh për tu infektuar sesa moshatarët e tyre të vaksinuar.

Sipas sondazhit IPSOS për Forumin Ekonomik Botëror (24 korrik - 7 gusht 2020), 74% e të anketuarve pajtoheshin (37%) ose pajtoheshin disi në pyetjen nëse do të vaksionohen kur të krijohet mundësia. 40% mbanin një qendrim totalisht kundër vaksinimit, pasi 56% ishin të shqetësuar për efektet anësore, 29% mendonin se nuk do të ishte efektive, 19% se nuk janë të rrezikuar dhe 17% mbanin një qendrim kundër vaksinave në përgjithësi.

2.2 Argumente pro vaksinimit

Certifikimi shëndetësor mund të ketë shumë përfitime, duke mundësuar qasje më të madhe dhe më të sigurt në udhëtimet ndërkombëtare, muzikë, teatër ,ngjarje sportive, bare, restorante, hotele dhe palestra. Nga ana tjetër lejimi i njerëzve që të kthehen në punë,të takohen lirisht me miqtë e tyre sjell shumë përfitime sociale, emocionale dhe ekonomike (Vance, M. A. 2011).

Kishi, R., Wolfson, A., Lim, M.-G., Stall, H., & Jones, S. (2021) pohojnë se në Mbretërinë e Bashkuar, certifikimi shëndetësor Covid-19 po përdoret në një numër të kufizuar fushash, përfshirë vizitat në shtëpitë e kujdesit, pjesëmarrjen në aktivitetet sportive, muzikore etj. Izraeli ka operuar një skemë të "kartës jeshile" në formën e një aplikacioni që tregon nëse njerëzit janë vaksinuar plotësisht ose tashmë kanë kaluar Covid 19, duke lejuar kështu qasje në palestra, hotele, teatro dhe koncerte.

Një studim i ndërmarrë në kuadër të qëndrimeve ndaj certifikatave të vaksinimit identifikoj se 72% e të anktuarve mbështetën vaksinimin e detyruar (42% fuqishëm) ndërsa 11% e kundërshtuan me forcë. Mbështetja ishte më e fortë në grupmoshat më të vjetra, dhe nuk kishte lidhje me gjininë ose statusin socio -ekonomik (WACHTER, P. E. (2015). Vaksinimi mbron individin nga dëmtimet e mundshme serioze. Vaksinimi gjithashtu kontribuon në mbrojtjen e komunitetit në përgjithësi dhe mbrojtjen e anëtarëve të tij në nevojë në mënyrë specifike. Duke pasur parasysh hezitimin e vaksinës, mund të jetë e nevojshme të detyrohet vaksinimi në mënyrë që të arrihet imuniteti masiv (Killmond, M. (2017).

2.3 Argumente kundër vaksinimit

Kundërshtimi i vaksinimit është po aq i vjetër sa vetë vaksinat. Arsyet pas pikëpamjeve kundër vaksinave janë të ndryshme, duke përfshirë besimet fetare dhe politike, si dhe shqetësimet në lidhje me sigurinë dhe efektivitetin e vaksinave të cilat shpesh bazohen në dezinformata. Ndoshta, rasti më i cituar në dekadat e fundit është teoria që lidh autizmin tek fëmijët me vaksinën MMR, një teori që është hedhur poshtë nga disa studime, por që ende përdoret si argument kundër vaksinimit.

Një nga arsyet më të përmendura në literaturë kundër vaksinimit të detyrueshëm identifikohet shqetësimi për efektet anësore të mundshme. Të anketuarit shprehin shqetësim për faktin sesa shpejt ishin zhvilluar vaksinat COVID-19 dhe theksonin se ende nuk kishte kaluar kohë e mjaftueshme për tu identifikuar të gjitha efektet anësore afatgjata. Në veçanti, raportet e fundit të mpiksjeve të mundshme të gjakut të lidhura me vaksinat u cituan nga një numër hezitues vaksinash, ku në vecanti vaksina AstraZeneca, ka qenë në fokus të polemikave të mpiksjes së gjakut në media.

Shqetësimet janë ngritur edhe nga perspektiva etike dhe ligjore. Këto përfshijnë privatësinë , heqjen e lirive civile, humbjen e kohezionit shoqëror nga krijimi i një hierarkie të re, diskriminimin ndaj disa grupeve shoqërore, dhe krimin, përfshirë falsifikimin, mashtrimin ose marrjen e dokumentacionit ose të dhënave në mënyrë të paligjshme.

Preferenca për 'imunitetin natyror' përbën një tjetër argument për tu mos vaksinuar. Autorët Bernstein, J et al (2017) identifikuan se një numër jo i vogël individësh nuk dëshirojnë të vaksinohen është sepse preferojnë ta "luftojnë" virusin "natyrshëm"

2.4 Qendrimet ndaj vaksinimit të detyruar në vende të ndryshme

Ashtu si globalisht, çështja e pasaportave të vaksinave ka qenë subjekt i diskutueshëm i debatit si në politikë ashtu edhe në media, me ata që kundërshtuan argumentimin se pasaportat e vaksinimit për shembull do të shkelnin liritë civile, dhe ata që i mbështesnin, duke argumentuar se kjo mund t'u mundësojë njerëzve të ndihen më "të sigurt" në vendet publike dhe mund të "zhbllokojë ekonominë" (Shretta, R., Aguas, R., Chalkidou, K., Shah, H., Ruiz, F., & White, L. J. 2020) .

Në Gjermani sondazhi i kryer nga Killmond, Marie (2017) zbuloi se 51% e të anketuarve ishin kundër dhe 49% pro vaksinimit të detyrueshëm. Shkalla e miratimit ishte dukshëm më e lartë në mesin e atyre që do të vaksinoheshin vullnetarisht (59%) në krahasim me ata që refuzonin (27%).

Një studim amerikan me rreth 1000 të anketuar i kryer në shtator 2020 vlerësoi 'rregullat e vaksinës'. Aktivitetet që kërkojnë certifikim vaksinimi për të cilat shumica e njerëzve mendonin se do të vaksinoheshin ishin: vizitat spitalore (shkalla e mundshme e marrjes prej

70%), udhëtimi në një shtet tjetër (70%), udhëtime ajrore (68%), të shkuarit në punë (60%), pjesëmarrje në tubime të mëdha (59%), dhe qasje në shkolla (Corke, S. 2020).

Në Kanada qëndrimet e përgjithshme ndaj masave të shëndetit publik për të zvogëluar transmetimin e COVID-19 zbuluan se vaksinat shihen si një mjet për "t'u kthyer në normalitet" ndërsa një pjesë tjetër e individëve ishin hezitues për shkak të mungesës së besimit në efikasitetin e mundshëm te vaksina dhe shqetësimet mbi efektet anësore (Bentham et al 2021).

Sipas grupit të OBSH për hezitimin e vaksinave, komunikimi i dobët është një faktor i rëndësishëm në refuzimin e pranimit. Ky mund të jetë një problem si në vendet me të ardhura të larta, me programe vaksinimi me burime të mira, ku komunikimi i papërshtatshëm ose i dobët i programit të imunizimit mund të rrisë hezitimin e vaksinës ose refuzimin e plotë; ashtu edhe në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, ku burimet e pakta të komunikimit kufizojnë kapacitetin për të kundërshtuar informacionin negativ mbi vaksinat dhe për të arritur mbështetjen e komunitetit për programet e vaksinimit.

2.2Metodologjia

Qasja metodologjike që do të përdoret është ajo sasiore, duke mbledhur dhe gjeneruar të dhëna nëpërmjet studimit të rasteve të shumta. Këto të fundit mundësojnë të eksplorohet në thellësi ndikimi i një fenomeni ose ngjarjeje në jetën e një ose më shumë rasteve të studiuara .Për shkak të qëllimit analizues do të përdoret qasja deduktive. Deduksioni është qasja dominante e kërkimit në shkencat natyrore, ku ligjet paraqesin bazën e shpjegimit, lejojnë parashikimin e dukurive, parashikojnë shfaqjen e tyre dhe për këtë arsye lejojnë që ato të kontrollohen.

Popullata e këtij studimi është e përbërë nga qytetarë të grupmoshave të ndryshme nga 18 vjec deri në mbi 61 vjec në qytetet e Tiranës, Durrësit, Fierit dhe Vlorës. Nga kjo popullatë përmes kampionit të volitshëm do ti lejohet çdo individi të shprehi dëshirën për të marrë pjesë, duke e shpërndarë instrumentin përmes metodave online dhe duke mbledhur të dhënat prej atyre që përgjigjen.

Madhësia e kampionit nuk është paracaktuar për shkak të mungesës së një numri të saktë të popullatës dhe është arritur pas shpërndarjes së pyetësore online për një periudhë 2 javore. Në fund të kësaj periudhe është vënë re se pyetësorin e kanë plotësuar 230 persona prej të cilëve janë eleminiuar 3 individë për shkak të mungesës së përgjigjeve në një shkallë të madhe. Numri përfundimtar i kampionit është 227 individë.

Informacione të përgjithshme mbi kampionin

47% e pjesëmarrësve janë të gjinisë femërore dhe 53% të gjinisë mashkullore. 38% të pjesëmarrësve i përkasin kategorisë 18-28 vjec, 28 % kategorisë 29-39 vjec, 13% moshës 40-50 vjec, 12 % i përkasin moshës 51-60 vjec dhe një pjesë e vogël prej 9% i përkasin moshës mbi 61 vjec

.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve rreth 41% janë student dhe rreth 56% jetojnë në zonat urbane. 61 % të pjesëmarrësve pohojnë se ata nuk kanë marë asnjë dozë vaksine ndërsa pjesa tjetër rreth 31% pohojnë se janë vaksinuar. Një pjesë e konsiderueshme rreth 56% pohojnë se

nuk do të pranonin të vaksinoheshin, ndërsa pjesa tjetër rreth 44% pranonin se do të vaksinoheshin vullnetarisht.

Instrumenti matës

Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësori të bazuar në internet. Një sondazh në internet ka avantazhin e arritjes së një audience të madhe me shpejtësi me koston e krijimit të biaseve ndaj atyre që kanë qasje në platformën online. Instrumenti i përdorur është ndarë në 3 seksione kryesore: informacione të përgjithshme, faktorët që ndikojnë në gadishmërinë për tu vaksinuar dhe qendrimet ndaj një politike të vaksinimit të detyrueshëm.

2.3 Analiza

1. Gatishmëria e qyetatrëve për tu vaksinuar në mënyrë vullnetare

Në tabelën e mëposhtme shfaqet shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen nëse pjesëmarrësit do të vaksinohen në mënyrë vullnetare, duke u nisur nga mosha, gjinia dhe zona e banimit të tyre. Nga të dhënat e tabelës vihet re se gjinia nuk është një faktor përcaktues i gatsishmërisë për tu vaksinuar sepse përqindja më e madhe si e femrave dhe e meshkujve nuk pranojnë të vaksinohen në mënyrë vullnetare. Mosha nga ana tjetër është një faktor me rëndësi që përcakton në shkallë të madhe gatishmërinë e qytetarëve për tu vaksinuar. Kështu në tabelë vihet re se moshat më të reja të kategorisë 18-29 vjec kanë një përqindje shumë të ulët që shfaqin gatishmërinë për tu vaksinuar me dëshirë, dhe më pas kjo gatishmëri fillon rritet vazhdimisht në proporcion me moshën.

Faktori gjeografik, ai i zonës në të cilën pjesëmarrësit jetojnë tregon se ekzistojnë ndryshime në gatishmërinë e pjesëmarrësve për tu vaksinuar në mënyrë vullnetare bazuar në faktin nëse ata jetojnë në zona urbane apo rurale. Të dhënat në tabelë tregojnë se pjesë më e madhe e pjesëmarrsve që jetojnë në zona urbane do të pranonin të vaksinoheshin pa qenë nevoja të detyrohen, ndërsa pjesa më e madhe e personave që jetojnë në zona rurale refuzojnë të vaksinohen me dëshirë.

Variabli	**Po**	**Jo**
Gjinia Femër	**50 (47%)**	**56 (56%)**
Gjinia Mashkull	**47(39%)**	**73 (61%)**
Mosha 18-28 vjec	**6 (8%)**	**79 (92%)**
Mosha 29-39 vjec	**24 (38%)**	**39 (2%)**
Mosha 40-50 vjec	**19 (64%)**	**10 (34%)**
Mosha 51-61	**20 (74%)**	**7 (26%)**
Mosha mbi 61 vjec	**18 (90%)**	**2 (10%)**
Zona Urbane	**68 (54%)**	**59 (46%)**
Zona Rurale	**33 (33%)**	**66 (66%)**

Tabela1.1

Pjesëmarrësit janë pyetur gjithashtu mbi efektin që lajmet e marra në media mbi vakisnimin ndaj Covid-19 kanë pasur në gatishmërinë e tyre për tu vaksinuar dhe shumica prej tyre rreth 66 % pranojnë se lajme mediatike kanë ndikuar jashtëzakonisht shumë në gatishmërinë e tyre për tu vaksinuar me dëshirë dhe vetëm 34% pranojnë se nuk ka ndikuar aspak.

Grafiku1.2

Grafiku1.3

1- Jam i shqetësuar për efektet anësore të vaskinës;
2- Vaksina u krijua shumë shpejt;
3- Nuk besoj se vaksina është efektive në ndalimin e përhapjes së Covid-19;
4- Jam përgjithësisht kundër vaskianve
5- Një i njohuri im pati reaksion nga vaksina
6- Nuk mendoj se vaksina është e nevojshme pasi Covid-19 nuk është i rrezikshëm

Sipas të dhënave te dukshme dhe në grafik, arsyeja kryesor për tiu mos u nënshtruar vaksinimit është shqetësimi për efektet anësore të vaksinës e ndjekur nga besimi i ulët në efektivitetin e vaksinës.

Ndërkohë që në grafikun e mëposhtëm paraqiten qendrimet e qytetarëve mbi certifikimin e vaksinës, si një politikë që është ndërrmarë në shumë vende dhe kohët e fundit edhe në Shqipëri jo vetëm për lëvizjen e njerëzve, por edhe për aktivitete të ndryshme. Gjetjet tregojnë se pjesa më e madhe e pjesëmarrsve mendojnë se institucionet nuk duhet tiu kërkojnë punonjësve certifikatën e vaksinimit, një pjesë e vogël mendojnë se certifikata e vaksinës do duhet të kërkohet vetëm në institucione të caktuara si shkolla, spitale etj,



Grafiku 1.4

Faktorët që nxisin vaksinimin e detyrueshëm

Grafikët e mëposhtmë tregojnë perceptimin e qytetarëve mbi politikën e vaksinimit të detyrueshëm, nëse kjo politikë zhvillohet në kuadër të disa faktorëve të tillë punëismi dhe aksesueshmëria në vende publike. Nën këto kushte perceptimi i qytetarëve ka ndryshuar pothuajse tërësisht. Shumica prej pjesëmarrësve pranojnë se do të vaksinoheshin nëse punëdhënësi i tyre I kërkon vaksinim të detyrueshëm ose të paktën do të gjenin mundësi për certifikata fallco të siguruara nëpërmjet mënyrave informale.



Grafiku1.5



Grafiku1.6

Përfundime

Studimi zbuloi se pjesa më e madhe e të anketuarve nuk janë vaksinuar ende, lidhur kjo me karakteristikat e përgjithshme të kampionit ku pjesa më e madhe janë student, kategori e cila vetëm kohët e fundit i është nënshtruar vaksinimit me detyrim. Në Shqipëri kategoria e cila është vaksinuar në një nivel më të lartë se të tjerët janë kryesisht moshat mbi 61 vjec, që në këtë studim zënë një pjesë shumë të vogël.

Lajmet mediatike dhe shpeshtësia e përballjes me to është një tjetër faktor I identifikuar si një prej faktorëve që nxit qytetarët kryesisht të mos vaksinohen. Njerëzit ndajnë pretendime "të rreme" për COVID-19 dhe vaksinimin, pasi shpesh është e vështirë të zbulohet infromacioni me një përmbajtje plotësisht të saktë.

Arsyeja kryesore përse vaksinimi nuk shihet si një zgjidhje ndaj Covid-19 në Shqipëri është

shqetësimi i qytetarëve mbi efektet anësore të vaksinave dhe besueshmëria e ulët në efektivitetin e vaksinave. Studimi aktual tregon se qytetarët shqiptarë janë në përgjithësi kundër politikës së vaksinimit të detyrueshëm e sidomos ndaj asaj të ndërrmarë për studentët dhe për fëmijët nëse do të ndërrmeret një e tillë.

2 janë faktorët kryesorë që do të ndryshonin qendrimin e qyterarëve ndaj vaksinimit të detyrueshëm dhe do të rriste nivelin e të vaksinuarve në Shqipëri. Së pari nëse vaksinimi do të përdorej si një kusht për të hyrë në ambientet e punës dhe së dyti nëse do të përdorej si një kusht për të aksesuar bare, clube, stadiume, aktivitete sportive, kulturore etj Megjithatë studimi evidenton një nivel të lartë të falsifikimit të certifikave të vaksinimit nëse politika e vaksinimit të detyrueshëm do të shtrihet në kategori më të gjera të popullsisë sic janë të rinjtë.

Në përfundim mund të thuhet se në fazën aktuale të zhvillimit të Covid-19 në Shqipëri, qytetarët tashmë janë më tepër të frikësuar ndaj një shtrirjeje më të gjerë të politikës së vaksinimit të detyrueshëm sesa ndaj vetë virusit. Megjithatë shtrirja e një politike të tillë është padiskutim në kundërshtim me dëshirat dhe vullnetin e qytetarëve.

Rekomandime

1. Ndërtimi i një mjedisi me informacione të plota mbështetëse dhe transparente, që adresojnë dezinformimin. Kjo mund të realizohet duke vëzhguar dhe ndërtuar mekanizma të vëzhgimit

dhe monitorimit të mediave social për identifikimin e burimeve të keqinformimit mbi vaksinën kundra COVID-19 si dhe duke ndërtuar mekanizma për të menaxhuar në kohë reale keqinformimin.

2. Forcimi i kapaciteteve kombëtare për të mbledhur, analizuar dhe shpërndarë të dhëna të ndara sipas moshës, gjinisë dhe karakteristika të tjera të popullsisë, veçanërisht duke iu drejtuar grupeve më të margjinalizuar dhe më të pambrojtur gjatë dhe pas kësaj pandemie.

3. Duhet të punohet përmes komunikimit të riskut dhe angazhimit të komunitetit,të shkëmbehet informacion nga burime të besuara në lidhje me pranueshmërinë dhe planet e shtrirjes, detaje mbi popullatat për të cilat fillimisht janë dhënë përparësi vaksinimi.

4. Administrimi i vaksinave COVID-19 dhe vaksinimi i shpejtë i popullatave kërkon profesionistë të kujdesit shëndetësor të cilët duhet të jenë të aftë, të trajnuar e të motivuar. Për këtë arsye duhet të vlerësohen burimet ekzistuese njerëzore, si infermierët vaksinatorë dhe kryeinfermierët e qendrave shëndetësore, mjekë të përgjithshëm, koordinatorë të fushatës etj.

5. Pandemia e SARS-CoV-2 është një sfidë globale. Prandaj, koordinimi dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe rajonalë është një përbërës thelbësor i strategjisë së vaksinimit në mënyrë që të kemi qasje efektive dhe inovative gjatë përgjigjes dhe zgjidhjes së problemeve.

Bibliografia:

Benham, J. L., Lang, R., Burns, K. K., MacKean, G., Léveillé, T., McCormack, B., Sheikh, H., Fullerton, M. M., Tang, T., Boucher, J. C., Constantinescu, C., Mourali, M., Oxoby, R. J., Manns, B. J., Hu, J., & Marshall, D. A. (2021). Attitudes, current behaviours and barriers to public health measures that reduce COVID-19 transmission: A qualitative study to inform public health messaging. PLoS ONE, 16(2 February 2021), e0246941. https://doi.org/10.1371/journal.pone.0246941

Bernstein, J. (2017). The case against libertarian arguments for compulsory vaccination. Journal of Medical Ethics, 43(11), 792–796. https://www.jstor.org/stable/26535523

Corke, S. (2020). COVID-19 Pandemic Recovery: If the US and Europe Find the Will, Multilateralism Is the Way. Istituto Affari Internazionali (IAI). http://www.jstor.org/stable/resrep27583

Feng, Z., Towers, S. & Yang, Y. Modeling the effects of vaccination and treatment on pandemic influenza. AAPS J. **13**(3), 427–437 (2011).

Global Advisory Committee on Vaccine Safety, 29–30 November 2006. Safety of BCG vaccine in HIVinfected children. Weekly Epidemiological Record, 2007, 82:22.

IPSOS. Global Attitudes on a COVID-19 Vaccine, 2020. Available online: https://www.ipsos.com/sites/default/files/ct/news/ documents/2020-09/global-attitudes-on-a-covid-19-vaccine-ipsos-survey-for-wef-2020.pdf

Kheng, K. S., & Hasbullah, N. E. (2020). Should COVID-19 Vaccines Be Mandatory? Institute of Strategic and International Studies. http://www.jstor.org/stable/resrep29705

Killmond, Marie. "WHY IS VACCINATION DIFFERENT? A COMPARATIVE ANALYSIS OF RELIGIOUS EXEMPTIONS." Columbia Law Review 117, no. 4 (2017): 913–52. http://www.jstor.org/stable/44211504

Kishi, R., Wolfson, A., Lim, M.-G., Stall, H., & Jones, S. (2021). A NATIONAL EMERGENCY: HOW COVID-19 IS FUELING UNREST IN THE US. Armed Conflict Location & Event Data Project. http://www.jstor.org/stable/resrep30039

Kuehn, D., Llanos, M., & Richter, T. (2021). Executive Personalisation in the Time of COVID-19. German Institute of Global and Area Studies (GIGA). http://www.jstor.org/stable/resrep30195

National Vaccine Advisory Committee. (2017). Evaluation of the 2010 National Vaccine Plan Mid-course Review: Recommendations From the National Vaccine Advisory Committee. Public Health Reports (1974-), 132(4), 411–430. https://www.jstor.org/stable/26374143

Shretta, R., Aguas, R., Chalkidou, K., Shah, H., Ruiz, F., & White, L. J. (2020). The COVID-19 Vaccine: Do We Know Enough to End the Pandemic? Center for Global Development. http://www.jstor.org/stable/resrep29657

Vance, M. A. (2011). DISEASE MONGERING AND THE FEAR OF PANDEMIC INFLUENZA. International Journal of Health Services, 41(1), 95–115. http://www.jstor.org/stable/45140213

WACHTER, P. E. (2015). ANNUAL BIBLIOGRAPHY OF WORKS ABOUT LIFE WRITING,2014-2015. Biography, 38(4), 556–703. http://www.jstor.org/stable/24803075

Wolfe RM; Sharp LK (August 2002). "Anti-vaccinationists past and present". BMJ. **325** (7361): 430–2

World Health Organization. (2021). COVID-19 and mandatory vaccination: Ethical considerations and caveats. World Health Organization. http://www.jstor.org/stable/resrep35607